DALIDG-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020 - 1208 /47
-VI-
Data 16.03.2021

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| **Për :** | **Ramiz Lladrovci,** Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>**Labinot Halilaj,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| **Kopje:** | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së | |
| **Nga:** | **Trim Berisha,** Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL | Datë: 16.03.2021 Nr.020-1208/46 |
| **Zyrtarët përgjegjës:**<br>1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë<br>2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave<br>**Xhevat Tafa,** Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Vjosa Ahmetaj,** Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| **Lënda:** | Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit | |
| **Lloji i aktit:** | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin 12 Nr. 360/02-9351 për shfuqizimin e pikës 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 2, të vendimit Nr. 12/360-68569, të datës 29.11.2019 të Kuvendit Komunal dhe lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social,** i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gllogocit, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

| | |
|---|---|
| Për : | Goran Rakič, Ministër në MPL<br>Trim Berisha, ud. Sekretar i Përgjithshme në MPL |
| Kopje: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë |
| Përmes: | Muharrem Nitaj, Ministër në detyrë i MEA<br>Fatos Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm i MEA |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit |
| Lloji i aktit: | Vendimi 12 Nr.360/02-9351 për shfuqizimin e pikes 1.2, 3 dhe 4 të nenit 2 të vendimit Nr.12/360-68569, të dates 29.11.2019, të kuvendit komunal dhe lejimin e lidhjes së kontratave të reja për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave të caktuara sociale, në bllokun I dhe II në Drenasin III, miratuar nga KK Gllogoc |

Të nderuar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti

Ligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 12 Nr.360/02-9351 për shfuqizimin e pikes 1.2, 3 dhe 4 të nenit 2 të vendimit Nr.12/360-68569, të dates 29.11.2019, të kuvendit komunal dhe lejimin e lidhjes së kontratave të reja për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave të caktuara sociale, në bllokun I dhe II në Drenasin III, miratuar nga KK Gllogoc. |
| I miratuar me datë: 26.02.2021 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë:26.02.2021 |
| I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 02.03.2021 |

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në harmoni me Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Udhëzimin Administrativ 18/2010 Përmbatjen e kontratës për banesen me qira joprofitabile, Programin trevjecar të banimit 2019-2021 si dhe raportin e Komisionit për çeshtjen e banimit të përkohshëm në kuadër të Komunes së Gllogocit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
KUVENDI I KOMUNËS

12 Nr. 360/02 - 9351 dt. 26/02 2021

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1.neni 4 pika 1.1.neni 7 pika 1, neni 12 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-164, Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, dhe Vendimit Nr. 12-020-11267 të datës 27.02.2019 të Komisionit për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, Raportit Nr.06-020/04-6276, të dt.02.10.2021 dhe Rekomandimit Nr. 06-020/04-6276, të dt.11.02.2021, të këtij komisioni, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur të dt.**26.02.2021**, miraton këtë:

# V E N D I M

**Për shfuqizimin e pikës 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 2, të Vendimit Nr.12/360-68569, të dt. 29.11.20219, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënien në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social**

## Neni 1

1.1. Shfuqizohet pika 1 e nenit 2 të Vendimit Nr.12/360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të Banesës me *Nr. 14, Kati i II-të, në Blloku I* në Drenasin III, për znj. Bahtije Feka.

1.2. Shfuqizohet pika 2 e nenit 2, të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të *Banesës me Nr. 2, Llam. B.P.,* Blloku II në Drenasin III, për znj.Hajrie Makolli.

1.3. Shfuqizohet pika 3 e nenit 2 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të *Banesës me Nr. 9, Kati III-të/A, në* Bllokun II në Drenasin III, për znj. Hava Deliu.

1.4. Shfuqizohet pika 4 e nenit 2 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të *Banesës në Përdhesë III/A, Blloku II,* për znj. Kifete Gjeli.

## Neni 2

Lejohet lidhja e kontratave për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave të caktuara me qira joprofitabile në Bllokun I dhe II në Drenasin III, me këta përfitues të rinjë të cilët kanë bërë kërkesa për strehim:

2.1. Banesa me *Nr. 9, Kati i III-të/A, në Blloku II, (27m²)* i ipet në Shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar deri në thirrjen publike të ardhshme për aplikim), z. Ardian Uka nga fshati Gradicë.

2.2. Banesa *me Nr. 14, Kati i II-të, në Blloku I, (59m²),* i ipet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), znj. Kifete Gjeli- nënë

kryefamiljare, përkatësishtë të transferohet nga Banesa me Nr. 1, Përdhesë/A, në Bllokun II, në banesën e lartëcekur.

2.3. Banesa me *Nr. 2, Llam. B.P., në* Bllokun II, (33.45m²) i ipet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), znj. Fatbardha Muja-nënë kryefamiljare.

2.4. Banesa me *nr. 1, Përdhesë/A, në* Blloku II (21.50 m²), t'i ipet në shfrytëzim të përkohshëm (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), z. Bashkim Deliu.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Kryetari i Komunës duke nënshkruar kontratat me qira joprofitabile për shfrytëzimin e përkohëshem të banesave sociale më përfituesit bazuar në rekomandimin e Komisionit për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social dhe të miratuar nga Kuvendi Komunal-Drenas.

**Neni 4**

Me këtë Vendim do të njoftohen: Drejtoratët e Komunës së Drenasit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë dhe një mbetët për evidencë.

**Neni 5**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Labinot Halilaj**

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit